



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.47 dt.27.03.1997

**PER
FINANCIMIN NGA TE ARDHURAT E BASHKISE PER BLERJE
USHQIMESH, DRU ZJARRI PAGESE TE ENERGJISE ELEKTRIKE ETJ**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.27.03.1997, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mjedisit për financimin nga të ardhurat e Bashkisë për blerje ushqimesh, dru zjarri pagesë të energjisë elektrike etj, për nevojat e çerdheve të fëmijëve dhe në mbështetje të nenit.14 të ligjit Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”

V E N D O S I;

1. Dhënie e fondeve nga të ardhurat e Bashkisë Drejtorisë së Qendrës Ekonomike të Çerdheve.
 - për blerje ushqimesh, dru zjarri, energji elektrike, ujë, karburant, riparime, blerje materialesh etj me vlefë 3.000.000 lekë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mjedisit, Drejtoria e Financës si dhe Drejtoria e Qendrës Ekonomike të Çerdheve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

ORHAN SAKIQI

